



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Stilistikë Turke

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare
Semestri kur zhvillohet: Viti II / Semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor - Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Të marrë njohuritë bazë të lëndës Stilistikë Turke.
- Të njohë stilemen, normën stilistike dhe ngjyrimet stilistikore në gjuhën turke.
- Të kuptojë organizimin stilistik të tekstit në gjuhën turke.
- Të kuptojë shtrebbërimet stilistikore të llojeve të ndryshme në gjuhën turke.
-

Objektivat specifike lëndore:

- Të njohë elemente të fono-stilistikës, morfo-stilistikës, sintakso-stilistikës, leksiko-stilistikës
- Të njohë fjalëformimin në gjuhën turke dhe shtresimin sipas normës.
- Të njohë frazeologjinë e gjuhës turke.
- Të kuptojë semanto-stilistikën e gjuhës turke, lidhjet kuptimore dhe figurat letrare.
- Të dallojë ligjërimet dhe stilet funksionale.
- Të dallojë njësinë e stilemës në gjuhën turke.
- Të punojë me njësinë e stilemës në gjuhën turke në tekstet e përzgjedhura
- Të punojë me fjalorë të gjuhës turke për të pasuruar të shprehurit në gjuhën turke me stilema dhe shprehje të reja.
- Të dallojë shtrebbërimet stilistikore në gjuhën turke.